



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	01
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No.	05-7441
Nr.l faqeve Br.stranica No.pages	- 3 -
Data: Datum: Date:	11.10.2017
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**

**MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT**

**NË MES TË**

**Departamentit Shëndetësor të Burgjeve / Ministrisë së Shëndetësisë**

**dhe**

**Organizatës Joqeveritare “Kasnecët e Ardhmërisë” në Prishtinë**

**PËR BASHKËPUNIM PROFESIONAL, MONITORIM DHE MBËSHTETJE LIDHUR ME  
TRAJTIMIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE, TUBERKULOZIT, TË DREJTAT E NJERIUT  
DHE STIGMËN NË BURGJE**

Bazuar në nevojat e shërbimeve shëndetësore të burgjeve për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve ngjitëse në përgjithësi dhe tuberkulozit në veçanti në burgje, trajnimi profesional i stafit shëndetësor të burgjeve për trajtim të kësaj çështjeje, analiza e situatës dhe hulumtimet profesionale në dobi të trajtimit adekuat dhe profesional përmes monitorimit adekuat të drejtave të njeriut të pacienteve të burgosur dhe stigmatizimit të tyre, lidhë këtë marrëveshje:

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1.1 Me këtë marrëveshje mirëkuptimi përcaktohet mënyra e bashkëpunimit në mes të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB), Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) dhe Organizatës Joqeveritare “Kasnecët e Ardhmërisë” (OJQ KEA), për bashkëpunim profesional, monitorim dhe mbështetje lidhur me sëmundjet ngjitëse dhe tuberkulozin në burgje si dhe të drejtat e njeriut dhe stigma

1.2. Me këtë marrëveshje mundësohet bashkëpunimi i Organizatës Joqeveritare “Kasnecët e Ardhmërisë” (në tekstin e mëtejme si OJQ KEA), dhe Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (në tekstin e mëtejme si DShB) për të arritur qëllimin e kësaj marrëveshjeje sipas pikës 1.1 të këtij neni.

**Neni 2**  
**Organet zbatuese të marrëveshjes**

2. Me rastin e lidhjes së kësaj marrëveshjeje, organet kompetente të palëve të cilat zotohen për zbatimin e saj janë:

2.1. Organizatës Joqeveritare “Kasnecët e Ardhmërisë” - OJQ KEA, licencuar dhe zbatuese e programit të Tuberkulozit në Kosovë,

### Neni 3

#### Obligimet e organeve zbatuese të marrëveshjes

##### 3.1. Obligimet e OJQ KEA - së:

- 3.1.1. Ofrimin i mbështetjes së DShB lidhur me menaxhimin e sëmundjeve ngjitëse dhe tuberkulozit në burgje, njëjtë sikurse për qytetarët e tjerë.
- 3.1.2. Analizën, hulumtimin të situatës aktuale, së paku një herë në vit lidhur me specifikat e sëmundjeve ngjitëse dhe tuberkulozit në burgje.
- 3.1.3. Ndërmarrja e veprimeve të nevojshme profesionale bazuar në të gjeturat eventuale në analizë.
- 3.1.4. Mbështetja e stafit shëndetësor në parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe tuberkulozit, përmes:
  - 3.1.4.1. Monitorimin e mënyrës së qasjes dhe trajtimit të të burgosurve nga ana e stafit mjekësor në burgje,
  - 3.1.4.2. Monitorimi dhe mbështetja në përpilimin e planeve dhe protokolleve për parandalim, trajtim dhe rehabilitim,
  - 3.1.4.3. Monitorimi i të drejtave të njeriut dhe parandalimi i stigmatizimit të të sëmurit me sëmundje ngjitëse dhe tuberkuloz në burgje përmes formave të ndryshme dhe bisedave të drejta për drejta të të burgosurit.
  - 3.1.4.4. Monitorimi i të drejtave të njeriut lidhur me trajtimin shëndetësor të tyre në përgjithësi dhe trajtimin për sëmundjeve ngjitëse dhe tuberkulozit në veçanti.
  - 3.1.4.5. Garantimi i trajnimit të stafit dhe implementimi i proceduarve dhe protokolleve dhe të arriturave me të reja shkencore konform trajtimit të sëmundjeve ngjitëse dhe tuberkulozit në institucionet publike, publike private dhe private në vend.
  - 3.1.4.6. Mbështesë dhe trajnoj formën e diagnostikimit adekuat në pranim dhe gjatë qëndrimit në burg të rasteve dhe sugjeroj format dhe testet kualitative dhe të kohës.
  - 3.1.4.7. Mbështes, trajnoj dhe monitoroj aplikimin e protokolleve nacionale dhe specifike për tuberkuloz, DOTS programin dhe procedurat e tjera relevante.
- 3.1.5. Mbështetja e DShB për implantimin e programeve parandaluese, trajtimit dhe rehabilitimit të të burgosurve me sëmundje ngjitëse dhe tuberkuloz.
- 3.1.6. Mbështetjen e DShB në aspektin profesional për diagnostikim në pranim sipas Rekomandimeve Ndërkombëtare dhe atyre Kombëtare në burgje përmes formave të ndryshme shkencore dhe profesionale multidisciplinare.
- 3.1.7. Mbështetja dhe lidhshmëria e trajtimit dhe rehabilitimit të sëmundjeve ngjitëse dhe tuberkulozit gjatë fazës së përgatitjes së pranimit, lidhshmëria me institucionet që kanë bërë trajtim paraprak, lirimit dhe pas lirimit të tyre me institucione të tjera relevante të vendit.
- 3.1.8. Përpilimi i raporteve periodike sipas aktiviteteve të ndërmarra.
- 3.1.9. Raportet vjetore i dërgohen Drejtorit të DShB në MSh.
- 3.1.10. Vërejtjet dhe rekomandimet si dhe mënyra e menaxhimit të monitorimit dhe trajtimit bëhet sipas planit paraprak të aprovuar nga të dyja palët.
- 3.1.11. OJQ KEA ka mundësinë dhe të drejtat që në çdo kohë, më paralajmërim 24 orë më herët, të bëjë monitorimin e trajtimit të rasteve sipas proceduarve dhe protokolleve në fuqi.

##### 3.2. Obligimet e DShB-së

- 3.2.1. Të mundësoj OJQ KEA-në të veprojnë në mënyrë profesionale dhe pa pengesa për zbatim të marrëveshjes.
- 3.2.2. Të krijoj kushte adekuate të punës dhe të ofroj në dispozicion dokumentacionin dhe të gjitha çështjet e nevojshme.
- 3.2.3. Të përfillë sugjerimet, rekomandimet dhe të bashkëpunoj në tejkalimin e pengesave dhe vërejtjeve eventuale.